

Vitin e ardhshëm nëpër shkolla gjuha shqipe dhe ajo boshnjake do të vendosen si lëndë zgjedhore në Turqi. Programi dhe materialet e lëndës të gjuhës shqipe dhe boshnjake që do të vendosen në programin mësimor do të përgatiten nga Universiteti Trakya, raporton Anadolu Agency (AA).

Drejtori i përgjithshëm i Arsimit Bazë në Ministrinë e Arsimit të Turqisë, Dr. Cem Gençolu, në ceremoninë e nënshkrimit të protokollit në sallën e mbledhjeve të rektoratit të Universitetit Trakya, ka njoftuar se vitin e ardhshëm që nga klasa e 5-të gjuha shqipja dhe boshnjake do të vendosen në programin arsimor si lëndë zgjedhore.

Ai ka theksuar se kurrikula dhe materialet e mësimit për të dyja gjuhët do të përgatiten nga Universiteti Trakya. "Ne gjuhën boshnjake dhe atë shqipe nuk e vërejmë si një gjuhë të huaj, por si një prej gjuhëve që vendosin lidhjet e qytetërimit tonë të përbashkët. Në Bosnje dhe Hercegovinë ndodhen 6 mijë nxënës boshnjakë që mësojnë turqisht, edhe ne themi që edhe fëmijët tanë të mund t'iu shprehin atyre 'Dobri Dosli'. Shpresoj që edhe kjo nga pikëpamja jonë do të vlerësohet si një takim kulturor".

Ndërkohë rektori i Universitetit Trakya, Prof. Dr. Erhan Tabakolu, duke vënë në dukje se misioni dhe zgjerimi i tyre si universitet është Ballkani, ka theksuar se është krenari që universiteti i tyre do të përgatisë programet e këtyre mësimëve.

Ndërsa më pas protokoli është nënshkruar nga Gençolu dhe Tabakolu.

Në ceremoni kanë marrë pjesë zv/rektori i Universitetit Trakya, Prof. Dr. Mümin Şahin, dekani i Fakultetit të Lirësisë në Universitetin Trakya Prof. Dr. İlker Alp, drejtori i Drejtorisë Arsimore të qytetit Edirne, Hüseyin Özcan dhe pedagogë të Shkollës së Gjuhëve të Huaja të Universitetit Trakya.